

Notecia
1



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
DHOMA KOMBËTARE E NOTERISË

DEGA VENDORE TIRANË

NOTER ELIDA TAKE
ADRESA NJESIA ADMINISTRATIVE
NR. 5, RR. TISH DAIJA, GODINA NR.
9, NJESIA 1, HYRJA 1
TEL: 0698885621

KONTRATË SHITJE PASURI E LUAJTSHME

(KUOTA KAPITALI)

Nr. repertori: 1351

Nr. koleksioni: 858

Tirane më 19/12/2025



Ligjet referuese:

- 1.Ligji nr. 7850, datë 29/07/1994 "Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar
- 2.Ligji nr. 124/2024, datë 19/12/2024 "Për mbrojtjen e të dhënave personale"
- 3.Ligji nr. 110, datë 20/12/2018 "Për Noterinë", i ndryshuar

*Akti noterial përbëhet nga 2 fletë



A2025053770092638377



A2025053770092638377

REPUBLIKA E SHQIPERISE

DHOMA E NOTERISE TIRANE

STUDIO NOTERIALE ELIDA H.TAKE

Adresa: rr "Tish Daija" Kompleksi "Kika 2", Godina 9, njesia 1-Tirane

e-mail : mailto:elidatake@yahoo.it elidatake@yahoo.it Mobil.0698885621

Nr. 1351 rep.nr. 858 .kol.

Taksa e pulles u pagua

KONTRATË SHITBLERJE KUOTASH KAPITALI

Sot më datë 19.12.2025 (dymijë e njëzet e pese), para meje noterit publik, Elida H.TAKE, anëtar i Dhomës së Noterëve Tiranë, në zyrën time noteriale të ndodhur në rr "Tish Daija" Kompleksi "Kika 2", Godina 9, njesia 1-Tirane, u paraqitën personalisht palët kontraktuese të cilët më kërkuan hartimin e kësaj kontrate në përputhje me dispozitat e Kodit Civil, ligjit nr. 110/2018 "Për noterinë", ligjit nr. 9901, datë 14.04.2008, "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare" (i ndryshuar), ligjit nr. 9723, datë 03.05.2007, "Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit" (i ndryshuar) dhe statutit të shoqërisë "Klinika Akili" SHPK, me kushtet e mëposhtme:

I. PALET

Pala Shitëse: z. Olti PEÇINI, atësia Anastasamësia Valbona, shtetas Shqiptar, lindur në Tiranë dhe banues në TIRANË, me adresë Hajredin Ismaili, Nd. 3; H. 1; Ap. 18; Njësia Administrative Nr. 2; Njësia Bashkiake Nr. 2; 0000; Tiranë, lindur më 19/08/1977, gjendja civile "i martuar", madhor, me zotësi të plotë juridike për të vepruar, për identitetin e të cilit u garantova me Leternjoftim ID nr. 038934413 dhe nr. personal H70819177O..

Pala Blerëse: z. Gert Peshkatari, atësia Pavlo, amësia Fatmira, shtetas Shqiptar, lindur në Tiranë dhe banues në TIRANË, me adresë Andon Zako Çajupi; Nd. 3; H. 1; Ap. 18; Njësia Administrative Nr. 5; Njësia Bashkiake Nr. 5; 1019; Tiranë, lindur më 16/10/1977, gjendja civile "i martuar", madhor, me zotësi të plotë juridike për të vepruar, për identitetin e të cilit u garantova me Leternjoftim ID nr. 039920961 dhe nr. personal H71016123C, i cili paraqitet në këtë kontratë në cilësinë e ortakut të shoqërisë "Klinika Akili" SHPK.

Kushtet Paraprake

Shoqëria "Klinika Akili" SHPK, e regjistruar si person juridik pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit (QKB) me Certifikatë Regjistrimi NUIS (NIPT) M21927023J, me zyrë qendrore në Tiranë, Rruga Lord Bajron, Laprake, zona kadastrale 8310, numri i pasurisë 7/8, ndertesa me numer 62.Laprake (prane spitalit ushtarak) Tiranë. 100, me kapital të regjistruar 1.000,00 (një mijë) lekë; me ortak z. Gert PESHKATARI zoterues i 1 kuote = 66.67% te kapitalit te shoqerise dhe z. Olti PEÇINI zoterues i 1 kuote = 33.33% te kapitalit te shoqerise; me administrator z.Denis SHKALLA;

Pala shitëse është e interesuar të shesë kuotën që ai zotëron në shoqërisë "Klinika Akili" SHPK dhe pala blerëse është e interesuar të blejë këtë kuotë;

Për sa më lart palët bien dakord, për sa vijon:

II. OBJEKTI

2.1 Nëpërmjet kësaj kontrate pala shitëse z. Olti PEÇINI i shet 1 kuotë = 33.33% te kapitalit që zotëron në shoqërinë "Klinika Akili" SHPK, palës blerëse dhe konkretisht z. Gert PESHKATARI.



A2025053770092638377

2.2 Pas regjistrimit të kësaj kontrate në Qëndrën Kombëtare të Biznesit, ortak i vetëm i shoqërisë "Klinika Akili" SHPK do të jenë z.Gert Peshkatari, zotërues i 1 (një) kuotë e cila përfaqëson 100% të kapitalit të regjistruar të shoqërisë "Klinika Akili" SHPK.

III. ÇMIMI

3.1 Palët bien dakord që çmimi i shitjes së kuotës, objekt i kësaj kontrate, është 333,3 (treqind tridhjetë e tre presje tre) lekë. Çmimi i kontratës do të likuidohet nga pala blerëse në masën 333,3 (treqind tridhjetë e tre presje tre) leke nga z. Gert PESHKATARI , direkt në llogarinë bankare të komunikuar nga pala shitëse z. Olti PEÇINI, brenda 7 ditëve nga nënshkrimi i kësaj kontrate.

3.2 Për çdo vonesë në pagesën e çmimit, do të aplikohet një interes në masën 10% në vit.

IV. TË DREJTA DHE DETYRIME TË PALËVE

4.1 Pala blerëse dhe/ose personat e caktuar prej saj ka/në të drejtë të ketë akses në të gjithë dokumentacionin juridik, financiar dhe teknik të shoqërisë "Klinika Akili" SHPK.

4.2 Pala blerëse detyrohet të paguajë çmimin e kontratës, brenda afatit të përcaktuar në pikën 3.1 të kësaj kontrate.

V. KALIMI I PRONËSISË

5.1 Palët kanë rënë dakord që kjo kontratë shitblerje kuotash kapitali, të regjistrohet në Zyrën e Regjistrimit Tregtar, në Qendrën Kombëtare të Biznesit (QKB), menjëherë pas nënshkrimit të saj, z.Gert PESHKATARI do të jetë ortak i vetëm zotëruesi i 1 kuotë = me 100% të kapitalit të regjistruar të shoqërisë "Klinika Akili" SHPK.

5.2 Nga momenti i regjistrimit të kësaj kontrate në Zyrën e Regjistrimit Tregtar, pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit (QKB) pala shitëse, humbet çdo të drejtë pronësie mbi kuotën e shitur prej 33.33% të kapitalit të shoqërisë në shoqërinë "Klinika Akili" SHPK.

Kjo kontratë hartohet në 4 (kater) origjinale në gjuhën shqipe, nga të cilat një qëndron në arkivën noteriale, një origjinal regjistrohet në Zyrën e Regjistrimit Tregtar, pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit (QKB) dhe më pas qëndron në zyrën qendrore të shoqërisë dhe nga një origjinal e merr secila palë.

Kjo kontratë pasi iu lexua me zë të lartë palëve nga unë noteri publik, ata më deklaruan që ajo është në përputhje të plotë me vullnetin e tyre të lirë, u nënshkrua prej tyre në praninë time dhe unë noteri e vërtetoj atë në bazë të ligjit.

PALA SHITËSE
Olti PEÇINI

PALA BLERËSE
Gert PESHKATARI

NOTER
Elida H.TAKE